



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr.14, datë 07.11. 2022

PËR

PËR MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT TË FREKUENCAVE TË DHËNA SIPAS REGJIMIT TË AUTORIZIMIT INDIVIDUAL DHE REGJIMIT TË AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM SI DHE PËR TRANSFERIMIN E TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE TË CAKTUARA NË AKTET RREGULLATORE TË NXJERRA NGA AKEP NGA SIPËRMARRËSI “ALBTELECOM SH.A.” TE SIPËRMARRËSI “ONE TELECOMMUNICATIONS SH.A.”

Këshilli *Drejtues (KD)* i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*AKEP*), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Znj.	Ketrin Topçiu	Anëtar
Znj.	Xhoana Lilaj	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 07/11/2022, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe Ligjit nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me propozim të Drejtorisë së Autorizimeve, Drejtorisë Teknike, Drejtorisë së Tregjeve dhe Masave Rregullatore, Drejtorisë së Monitorimit Kontrollit dhe Inspektimit, Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtorisë së të Drejtave të Përdoruesit dhe Drejtorisë Juridike dhe Integritetit, shqyrtoi kërkesën me objekt:

- “Për miratimin e transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të dhëna sipas regjimit të autorizimit individual dhe regjimit të autorizimit të përgjithshëm si dhe për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 13 e vijues, 71, 74, 83, 84, 114 dhe 115 të Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji nr.9918/2008);
2. Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, (Ligji nr.44/2015);
3. Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
4. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.636, datë 29.7.2020 “Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit”;
5. Rregullore nr.47, datë 26.10.2017, “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm” (Rregullore nr.47/2017);
6. Rregullore nr.30, datë 05.12.2013 “Për dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave”;
7. Rregullore nr. 10, datë 11.08.2009 “Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike” (Rregullore nr.10/2009).
8. Rregullore nr.49, datë 11.03.2021 “Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Shkresat e sipërmarrësve “Albtelekom sh.a.” dhe “One Telecommunications Albania sh.a.”:
 - Kërkesë e sipërmarrësit “One Telecommunications sh.a.” drejtuar AKEP me shkresën nr. 5479, datë 31.10.2022;
 - Kërkesë e sipërmarrësit “Albtelecom sh.a.” drejtuar AKEP me shkresën nr. 5305, datë 31.10.2022
2. Projekt-Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacionin shoqërues të Projekt-Vendimit;
4. Raport vlerësimi mbi përmbushjen e detyrimeve të sipërmarrësve, hartuar nga Drejtoritë përkatëse të AKEP.

V Ë R E N:

1. Sipërmarrësi i komunikimeve elektronike “Albtelecom” sh.a., nëpërmjet njoftimit zyrtar me nr.2502, datë 21.12.2021, ka kërkuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) dhënien e miratimit paraprak për ndryshimin e strukturës së aksionarëve në favor të shoqërisë hungareze “4iG”, duke deklaruar se në strukturën aksionare të kësaj shoqërie nuk ka asnjë pjesëmarrje apo kontroll të çfarëdo lloji të operatorëve të tjerë të komunikimeve elektronike në Shqipëri.

2. AKEP, me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.1, datë 10.01.2022, ka unifikuar qëndrimin sa i përket *ratio legis* të nenit 71 dhe 74 të Ligjit nr.9918/2008, mbi dhënien e miratimit paraprak për rastet e transferimit të të drejtës së përdorimit të Autorizimeve Individuale nga sipërmarrësi mbajtës i kësaj të drejte tek një sipërmarrës tjetër. Në këtë kuptim, duke mbajtur në vëmendje, gjithashtu, dhe parashikimin ligjor të dhënë në nenet 6 dhe 8 të Ligjit nr. 9918/2008, në të cilat parashikohet se AKEP është autoriteti i vetëm rregullator përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e sektorit të komunikimeve elektronike si dhe për lëshimin e autorizimeve individuale për përdorimin e brezave të frekuencave sipas Planit Kombëtar të Frekuencave, kompetenca institucionale e tij në çështjen objekt shqyrtimi kufizohet në ushtrimin e veprimtarisë administrative për kryerjen e ndryshimeve të pronarëve apo përfaqësuesve ligjorë në Njoftimin e Autorizimit të Përgjithshëm dhe në Autorizimet Individuale që mbahen nga sipërmarrësi.
3. Njoftimi mbi përfitim të kontrollit të shoqërisë “Albtelecom” sh.a., nga shoqëria “4iG”, përmes blerjes dhe zotërimit të 80.27% të kapitalit aksionar të shoqërisë “Albtelecom” sh.a., është përcjellë dhe pranë Autoritetit të Konkurrencës. Në datën 14 Janar 2022 Komisioni i Konkurrencës, me anë të Vendimit nr.855, ka vendosur për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nga përfitimi i kontrollit nëpërmjet blerjes së 80.27% të aksioneve të shoqërisë Albtelecom sh.a., nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag (4iG Nyrt).
4. Sipërmarrësi i komunikimeve elektronike “One Telecommunications” sh.a., nëpërmjet shkresës zyrtare me nr.73, datë 21.01.2022, ka njoftuar Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare mbi ndryshimin e strukturës së aksionarëve në favor të shoqërisë hungareze “4iG”. Bazuar në marrëveshjen e shitjes dhe të blerjes (SPA) blerësi përfiton 100% të aksioneve të zotëruara nga shitësi “Albania Invest” dhe nëpërmjet këtij transaksioni, shoqëria blerëse përfiton kontrollin mbi shoqërinë “One Telecommunications” sh.a.
5. AKEP, me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 3, datë 27.01.2022 ka miratuar qëndrimin e tij lidhur me njoftimin zyrtar të sipërmarrësit “One Telecommunications” sh.a., duke pasur në vëmendje se mbetet në kompetencë të Autoritetit të Konkurrencës, si institucion përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës efektive, vlerësimi apo verifikimi, nëse marrëveshja e lidhur midis dy shoqërive paraqet premisa për deformime të konkurrencës në treg. AKEP ka theksuar se ndryshimet përkatëse në autorizimet e lëshuara nga AKEP do të reflektohen vetëm pas dhënies së miratimit nga Autoriteti i Konkurrencës për kryerjen e këtij transaksioni dhe pasqyrimin të këtyre ndryshimeve në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
6. Në datën 31 Janar 2022 Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit nr.861 ka vendosur fillimin e procedurës së thelluar për vlerësimin e transaksionit të ndodhur nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag. Fillimi i kësaj procedure është vendosur pas depozitimit të njoftimit pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi përfitim të kontrollit nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag, si edhe, pasi është kryer vlerësimi paraprak mbi bazën e të cilit është konstatuar se transaksioni i propozuar pritet të sjellë bashkim mes dy operatorëve në tregun celular (One Telecommunications dhe Albtelecom), duke reduktuar numrin e operatorëve celularë nga 3 në 2 (Vodafone Albania sh.a., dhe operatori i bashkuar).

7. Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 176/2, datë 17.03.2022 “Dërgim Vendimi” (protokoll i AKEP nr.73/5, datë 23.03.2022) ka njoftuar vendimin e Komisionit të Konkurrencës (KK) nr.869, datë 08.03.2022 *“Mbi përfitim të kontrollit të shoqërisë Albania Telecom Invest Ad nga shoqëria 4ig Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag”*.
8. KK ka vendosur të autorizojë përqendrimin e realizuar nga përfitimi i kontrollit të shoqërisë Albania Telecom Invest Ad nga shoqëria 4ig Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag” me kushte dhe detyrime për shoqërinë 4ig Nyrt.
9. KK ndër të tjera ka vendosur t’i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare sa më poshtë:
- ✓ Të realizojë analizën e tregut me pakicë të shërbimit të telefonisë fikse dhe celulare, duke shpallur operatorët me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT), si dhe duke përcaktuar masa rregulluese/detyrime sipas përcaktimeve ligjore.
 - ✓ Të hartojë një rregullore ku të përcaktohen procedurat për licencimin e operatorëve të rinj, Operatorë të Rrjetit Virtual Celulare.
 - ✓ Të vendosë rregulla dhe detyrime për operatorët ekzistues në tregun e telefonisë fikse dhe celulare, që të lejojnë akses, interkoneksion dhe përdorim të përbashkët të faciliteteve të rrjetit për hyrjen në treg të Operatorëve të Rrjetit Virtual Celular.
 - ✓ Në kuptim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, t’i propozojë Këshillit të Ministrave ndryshime në “Planin Kombëtar të Frekuencave”, pas ndryshimit të strukturës së tregut të komunikimeve elektronike.
10. AKEP, përmes shkresës nr.prot 73/6, datë 29.04.2022 ka sqaruar AK lidhur me rekomandimet e dhëna duke i adresuar problematikat përkatëse në përputhje me kompetencat e tij dhe legjislacionin në fuqi.
11. Duke marrë parasysh legjislacionin e përgjithshëm dhe sektorial mbi mbrojtjen e konkurrencës, rekomandimet e KK, dhe kompetencat e tij si autoritet administrues i pjesës së spektrit të frekuencave që është dhënë në përdorim për komunikimet elektronike, AKEP i ka tërhequr vëmendjen të tre sipërmarrësve për të reflektuar dhe bashkëpunuar për gjetjen e një zgjidhje mbi rekomandimet e AK si edhe arritjen e një dakordësimi për ribalancim të spektrit midis tyre.
12. Sipërmarrësit, me shkresën e datës 28.10.2022, nr.prot 5159/1 One Telecommunications sh.a., nr.prot 5075/1 Albtelecom sh.a., nr.prot CEO/044/JL Vodafone Albania sh.a., me lëndë: *“Mbi finalizimin e negociatave lidhur me procesin e ribalancimit të frekuencave në tregun e komunikimeve elektronike”* njoftuan AKEP se, pas disa raundesh bisedimesh, kanë arritur dakordësinë teknike dhe financiare për kalimin e një numri të caktuar të drejtash përdorimi të frekuencave nga shoqëritë One Telecommunications sh.a., dhe Albtelekom sh.a., tek Vodafone Albania sh.a.
13. Krahës kësaj, të tre sipërmarrësit e kanë njoftuar zyrtarisht AKEP me shkresën nr.73/13 Prot, datë 04.11.2022, për nënshkrimin e një Memorandumi Bashkëpunimi midis palëve, i cili i paraprin marrëveshjes për shitjen dhe transferimin e frekuencave që do të përmbyllet brenda datës 31.12.2022.

14. Përmes shkresës me nr.5305 prot., datë 31.10.2022, sipërmarrësi “Albtelekom sh.a.” i është drejtuar AKEP me kërkesën me lëndë: “Kërkesë për miratim paraprak për transaksionin e pritshëm në tregun e komunikimeve elektronike për bashkimin me përthithje të shoqërisë ALBtelecom sh.a., nga ana e shoqërisë One Telecommunications sh.a., dhe për kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP si dhe në Autorizimet e Përgjithshme dhe Individuale tek subjekti tregtar përthithës”, ku kërkon kalimin e të gjithë të drejtave dhe detyrimeve tek sipërmarrësi One Telecommunication sh.a si dhe të gjithë frekuencave përvec atyre që do ti kalojnë sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a.

15. Përmes shkresës me nr.5479 prot., datë 31.10.2022, sipërmarrësi “One Telecommunications” sh.a., i është drejtuar AKEP me kërkesën me lëndë: “Mbi miratimin paraprak për transaksionin e pritshëm në tregun e komunikimeve elektronike për bashkimin me përthithje të shoqërisë ALBtelecom sh.a., nga ana e shoqërisë One Telecommunications sh.a., dhe për kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP si dhe në Autorizimet e Përgjithshme dhe Individuale tek subjekti tregtar përthithës”.

16. Shkresat e mësipërme shoqërohen nga dokumentacionet shpjeguese si edhe nga:

- Vendimi Qarkullues nr.11, datë. 27.07.2022 i Këshillit të Administrimit të shoqërisë Albtelecom sh.a.;
- Vendimi i Bordit të Drejtorëve të One Telecommunications sh.a., nr.351 datë. 01.08.2022;
- Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të One Telecommunications sh.a., nr.33 datë 02.08.2022;

si organe vendimmarrëse të shoqërive Albtelecom sh.a., dhe One Telecommunications sh.a., të cilat kanë miratuar fillimin e procedurave ligjore të bashkimit të shoqërive në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, i ndryshuar, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, bashkim i cili pritet të përfundojë në datën 31.12.2022.

A R S Y E T O N:

A. Vlerësimi i përgjithshëm për përmbushjen e kërkesave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara nga ligji dhe aktet rregullatorë.

1. Kërkesa objekt shqyrtimi për kalimin e autorizimeve, të drejtave dhe një pjesë e të drejtave të përdorimit të frekuencave është e bazuar mbi projektin e bashkimit me përthithje të shoqërisë “Albtelekom” sh.a., nga shoqëria “One Telecommunications” sh.a.. AKEP konstaton se kërkesat e paraqitura nga të dy sipërmarrësit përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm dhe për pasojë i gjen ato normativisht të përligjura.
2. Sipas nenit 215, pg./1 i ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar, bashkimi me përthithje është kalimi i “të gjitha aktiveve e pasiveve të njëjës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve

apo kuotave të kësaj shoqërie”. Neni 220, pg./3 i këtij ligji përcakton se regjistrimi i bashkimit të shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ka këto efekte:

“a) ka pasojë kalimin te shoqëria përthithëse e të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që përthithet. Ky transferim ka pasoja si në marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, ashtu edhe te palët e treta;

b) bën që aksionarët apo ortakët e shoqërisë së përthithur të bëhen aksionarë apo ortakë të shoqërisë përthithëse;

c) bën që shoqëria që përthithet të vlerësohet e prishur, ndaj çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, pa kaluar në procesin e likuidimit.”

3. Neni 214, pg./4 i ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar, shprehet se “bashkimi i shoqërive kryhet në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e konkurrencës.” Më tej, neni 12, pg./1 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, Për mbrojtjen e konkurrencës përcakton se përqendrimet e ndërmarrjeve njoftohen në Autoritet për të marrë autorizim”. Në përputhje me këtë kornizë ligjore, kërkuesit kanë njoftuar dhe kanë marrë autorizimin për përqendrimin e shoqërive “Albtelekom” sh.a., me shoqërinë “One Telecommunications” sh.a. Komisioni i Konkurrencës ka konstatuar me të drejtë se “transaksioni i propozuar pritët të sjellë bashkimin mes dy operatorëve në tregun celular (One Telecommunications dhe Albtelecom), duke reduktuar numrin e operatorëve celularë në 2, (Vodafone dhe operatori i bashkuar)” (pg./7 i Vendimit). Projekt-bashkimi me përthithje, i paraqitur AKEP bashkëlidhur kërkesës objekt shqyrtimi, përbën jetësimin në formën përfundimtare të transaksioneve të autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës.
4. Për rrjedhojë, në zbatim të kuadrit ligjor dhe në respekt të kompetencës ekskluzive të Komisionit të Konkurrencës në lëndën e autorizimit të përqendrimeve, AKEP, pasi konstatoi se nuk paraqitet asnjë pengesë ligjore formale, vlerëson se plotësohen kushtet për kalimin në mënyrë globale të gjithë autorizimeve dhe të drejtave të zotëruara nga shoqëria për t’u përthithur, Albtelekom, tek shoqëria përthithëse, One Telecommunication sh.a.
5. Në përputhje me nenin 83, pg./1, germa (c), AKEP vlerëson se përmbushen kriteret për kalimin e numeracionit dhe serive të numrave nga sipërmarrësi “Albtelekom” sh.a., tek sipërmarrësi “One Telecommunications” sh.a.
6. Duke qenë se sipërmarrësi Albtelecom sh.a., mbart detyrime rregullatore të përcaktuara pas proceseve të analizave të tregut për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike nga vendndodhje fikse, ashtu edhe ato të lëvizshme/mobile, të gjitha detyrimet e vendosura si FNT në mobile dhe fiks do t’i kalojnë sipërmarrësit One Telecommunications sh.a., si sipërmarrës me Fuqi të ndjeshme në treg dhe që plotëson kriteret për zbatimin e detyrimeve.

Përsa i përket përcaktimeve si FNT, detyrimet kanë të bëjnë me:

- Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendndodhje fikse (VKD nr.75, datë 01.10.2018);
- Tregu me shumicë i shërbimit të tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse (VKD nr.75, datë 01.10.2018);
- Tregu me shumicë të aksesit në nivel lokal në vendndodhje fikse (VKD nr.13, datë 14.05.2017);
- Tregu me shumicë të aksesit në nivel qendror për produkte të tregut të përgjithshëm (VKD nr.13, datë 14.05.2017);

- Tregun me shumicë të aksesit me cilësi të lartë në vendndodhje fikse (VKD nr.2702 dhe 2704, datë 22.12.2016);
 - Tregu me shumicë i aksesit në elementët pasive të infrastrukturës së rrjeteve në nivel kombëtar (VKD nr.2701 dhe 2703, datë 22.12.2016);
 - Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në kombëtare në rrjetet individuale të telefonisë së lëvizshme (VKD nr.73, datë 01.10.2018 dhe nr.11, datë 16.06.2020);
 - Tregu me shumicë i terminimit të SMS-ve, në rrjetet individuale të telefonisë së lëvizshme (VKD nr.2440, datë 27.03.2014).
9. Shoqëria përthithëse merr përsipër edhe të gjitha detyrimet kundrejt pajtimtarëve, për t'i mbajtur të njoftuar në mënyrën e duhur dhe në kohë pajtimtarët për bashkimin e shoqërive dhe sigurohet që ky bashkim nuk do të cenojë të drejtat dhe interesat e pajtimtarëve në asnjë aspekt, të tilla si standartet e cilësive se shërbimit, mbulimi, kujdesi ndaj klientit, ofrimi i shërbimeve të kontraktuara si dhe atyre të parashikuara në Rregulloren nr.49, datë 11.03.2021 “Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”.
10. Në vijim AKEP konstaton se Sipërmarrësit “Albtelecom” sh.a., dhe “One Telecommunications” sh.a., nuk rezultojnë debitorë në AKEP dhe nuk kanë detyra të papërbushura nga inspektimet e kryera nga AKEP.

B. Vlerësimi i efekteve të transferimit të frekuencave në tregun e komunikimeve elektronike

1. Pasi ka shterur aspektet e ligjshmërisë formale shqyrtimi nga AKEP i kërkesës për transferim të të drejtave të përdorimit të spektrit nga shoqëria “Albtelecom” te shoqëria “One Telecommunications” duhet të marrë parësisht në konsideratë termit dhe rekomandimet e vendimeve përkatëse të Komisionit të Konkurrencës mbi bashkimin me përthithje të dy shoqërive, brenda kornizës ligjore të përcaktuar në nenin 74, të ligjit 9918/2008.
2. Komisioni i Konkurrencës, përmes vendimit nr.869, datë 08.03.2022, ka lejuar bashkimin shoqërisë “Albtelekom” sh.a., me shoqërinë “One Telecommunications” sh.a. Në këtë vendim Komisioni i Konkurrencës ka konstatuar shprehimisht se *“transaksioni i përfuturit të kontrollit të shoqërisë One Telecommunications nga 4iG Nyrt do të sjellë për pasojë edhe bashkimin e volumit të spektrit sipas bandave respektive, duke i mundësuar dy shoqërive (One Telecommunications dhe Albtelecom) të kenë në përdorim rreth 59% të spektrit të frekuencave, ndërkohë që shoqëria Vodafone Albania sh.a., do të zotërojë rreth 41% të tij”* (pg./63 i Vendimit). Në vendim theksohet, gjithashtu, se në tregun e telefonisë celulare, *“pjesa e kombinuar e tregut të dy operatoreve (One dhe Albtelecom) në vitin 2021 rezulton të jetë nga 42% deri në 55%, ku dy shoqëritë do të zotërojnë së bashku më shumë se gjysmën e tregut sipas treguesit të: përdoruesve aktive të shërbimeve celulare; përdoruesve aktive të aksesit broadband celular dhe volumit të thirrjeve telefonike dalëse drejt rrjeteve fikse dhe celulare”* (pg./69 i Vendimit).

3. Në pikën II.4 të dispozitivit, Komisioni i Konkurrencës ka vendosur “*t’i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare sa më poshtë: 4. Në kuptim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, t’i propozojë Këshillit të Ministrave ndryshime në “Planin Kombëtar të Frekuencave”, pas ndryshimit të strukturës së tregut të komunikimeve elektronike.*”
4. Këtë rekomandim të Komisionit të Konkurrencës, pavarësisht termave të përdorur, AKEP e sheh ngushtësisht të lidhur me dy konstatimet e sipërcituara. Rekomandimi synon që zotërimi i të drejtave të përdorimit të frekuencave të reflektojë strukturalisht një spektër të balancuar dhe një treg të telefonisë së lëvizshme të ekuilibruar, të pacenuar nga përqendrimi i autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës.
5. Në cilësinë e autoritetit administrues të pjesës së spektrit të frekuencave që është dhënë në përdorim për komunikimet elektronike si dhe i vetëdijshëm për kompetencat e tij ligjore në mbrojtje të konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike, AKEP e bashkëndan plotësisht vlerësimin e kryer nga Komisioni i Konkurrencës për sa i përket detyrimit për një spektër të përpjesëtuar drejt, si kusht thelbësor për konkurrencën efeciente në tregun e telefonisë së lëvizshme.
6. Qëndrimi parimor i AKEP i është bërë me dije të tre sipërmarrësve të telefonisë së lëvizshme, duke nënvizuar se është në interes të një tregu të maturuar dakordësimi i ribalancimit proporcional të spektrit mes operatorëve aktivë, në mënyrë që të ndikojë në ekuilibrimin e tregut përmes një përpjesëtimi të ri në çdo brez të spektrit, duke qenë se secili brez ofron mundësi zhvillimi të një teknologjie të caktuar.
7. Në këto kushte, të tre sipërmarrësit e pajisur me të drejta përdorimi të spektrit kërkuar nga AKEP garantimin e paanshëm të një raundi bisedimesh mes tyre, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje teknike të përshtatshme e cila do të lehtësonte një marrëveshje përfundimtare për një përpjesëtim të ri të spektrit, duke synuar kështu një vetërregullim sa më optimal të tregut përpara se bashkimi me përthithje i shoqërive One Telecommunications dhe Albtelekom të hynte në fuqi.
8. Në prizmin e kësaj kornize ligjore dhe detyrave të lëna nga Autoriteti i Konkurrencës, AKEP mori në shqyrtim Mirëkuptimin e arritur në datën 26.10.2022, sikundër rezultoi nga shkresa e përbashkët e tre sipërmarrësve datë 28.10.2022, dhe nga memorandumi i mirëkuptimit datë 04.11.2022, depozituar në AKEP më datë 04.11.2022.
9. AKEP e vlerësoi këtë Marrëveshje në bazë të tre kritereve thelbësore ligjore:
 1. shmangia e deformimeve në konkurrencë;
 2. përdorimi eficient i spektrit të frekuencave;
 3. mbrojtja e interesit publik.
10. Në radhë të parë, AKEP vëren se marrëveshja tripalëshe ka për objekt kryesor një përpjesëtim të ri dhe të drejtë të spektrit, përmes shitjes së një pjese të të drejtave të përdorimit të shoqërive Albtelekom dhe One Telecommunications (shoqëria e bashkuar) të shoqëria Vodafone, duke arritur një balancim optimal të spektrit nga 59% me 41% në rreth 51% me 49%, sipas tabelës së mëposhtme:

ID Bloku	Bandat e Frekuencave [MHz]	Shoqëritë që kanë spektër për transferim tek Vodafone Albania	Bloqet e Spektrit [MHz]	Data për transferim të spektrit	Data e përfundimit të AI
A	1800 FDD	ONE (ex-PL)	2 x 4.5	01.05.2023	25.06.2024
B	1800 FDD	ALBtelecom	2 x 5.5	31.12.2022	01.03.2034
C	1800 FDD	ALBtelecom	2 x 1.7	31.12.2022	01.03.2034
D	2100 FDD	ONE	2 x 5	01.12.2023	30.06.2026
E	2600 FDD	ALBtelecom	2 x 20	31.12.2022	01.05.2031

11. Përmes kërkesës objekt shqyrtimi, Albtelekom ka kërkuar transferimin drejt ONE të një pjese të të drejtave të përdorimit të frekuencave në zotërimin e tij. ***Sipas marrëveshjes, pjesa e mbetur e të drejtave të përdorimit të frekuencave në zotërimin e tij (Sipas tabelës, bloqet B, C dhe E) do t'i transferohen Vodafone brenda datës 31.12.2022.*** Në zbatim të kësaj Marrëveshje, Vodafone do të përftojë edhe të drejtat e përdorimit të frekuencave që do të lëshohen nga One Telcommunications (sipas tabelës, bloqet me ID A dhe D).
12. AKEP çmon se një rikonfigurim i tillë (51% me 49%, përkatësisht operatori i bashkuar dhe Vodafone sh.a.), rivendos ekuilibrin e munguar, duke shmangur një detyrim të mëtejshëm të shoqërisë së bashkuar për të hequr dorë nga të drejta përdorimi në mënyrë të njëanshme dhe të detyruar dhe për t'ia rikthyer Shtetit kundrejt një kompensimi financiar proporcional.
13. Në kuadër të shmangies së deformimeve në konkurrencë, rezulton gjithashtu nga marrëveshja se përpjesëtimi i ri i propozuar, përveçse gjen mirëkuptimin e palëve duke adresuar kështu shqetësimin e shfaqur në vendimin e Komisionit të Konkurrencës (pg./63), garanton shmangien e barrierave të larta për hyrjen e një operatori të ri në treg, pasi një sërë brezash të përshtatshëm për zhvillimin e teknologjive 4G dhe 5G mbeten të lirë për t'u dhënë në përdorim. Për sa i përket mundësisë së hyrjes në treg të një operatori virtual, AKEP çmon se kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi është i përshtatshëm për adresimin e ngërçeve që mund të shfaqen, por që nuk mund të parashihi apo të paragjykohe për aq kohë sa nuk ka një shprehje interesi nga një sipërmarrës potencial në këtë drejtim.
14. AKEP vlerëson se edhe për sa i takon përdorimit eficient të spektrit, marrëveshja mes tre operatorëve bazohet mbi një zgjidhje optimale, pasi siguron që brezat e liruar nga shoqëria e bashkuar – 80Mhz në total, përveçse rishpërndahen duke garantuar konkurrencën e lirë dhe eficiente, do të vijojnë të shfrytëzohen nga shoqëria blerëse menjëherë pas pajisjes së saj me autorizimet përkatëse. Vijimi i përdorimit eficient të këtyre brezave, burime natyrore të fundme, do të vazhdojë kështu të nxisë investimet për një mbulim dhe një cilësi shërbimi më të mirë në funksion të objektivitetit të ndërlidhjes

me cilësi dhe shpejtësi të lartë, të besueshme, të qëndrueshme dhe të sigurtë, prioritet i politikave sektoriale dhe detyrim që rrjedh nga implementimi i Kodit Europian të Komunikimeve Elektronike.

15. Së fundmi, AKEP gjykon se përpjesëtimi i ri i spektrit, siç rezulton nga marrëveshja e sipërcituar, është në përputhje me interesin publik për këto arsye:

- Garanton shmangien e deformimeve në konkurrencë;
- Siguron përdorimin eficient të spektrit.

16. Duke shmangur heqjen dorë të shoqërisë së bashkuar, me detyrim dhe në mënyrë të njëanshme, nga të drejtat e përdorimit që zotëron në mënyrë të ligjshme, marrëveshja shmang gjithashtu barrën financiare të kompensimit që binte mbi Shtetin, mosshfrytëzimin në vijimësi të 80 Mhz të liruar, si dhe humbjen e të ardhurave shtetërore nga mbledhja e tarifës së radiokomunikimit.

17. Në këto kushte dhe duke pasur parasysh se në çdo rast AKEP do të vijojë të mbikëqyrë në mënyrë sistematike dhe të thelluar efektet e përpjesëtimit të ri të spektrit, transferimi i të drejtave, kërkuar nga shoqëritë Albtelekom dhe One Telecommunication, nuk shfaq elementë të shtrembërimit të konkurrencës në kuptim të nenit 74, të ligjit 9918/2008 dhe VKM 636/2020 dhe përmbush kushtet për t'u autorizuar me efekt nga data e hyrjes në fuqi e bashkimit me përthithje dhe pasqyrim të tij në ekstraktet përkatëse të shoqërive në regjistrin tregtar.

18. Në mënyrë që të garantohet përdorimi i rregullt, i sigurt dhe eficient, i spektrit të frekuencave, numrave dhe serive numerike, AKEP do të miratojë kalimin e këtyre të drejtave dhe detyrimeve të sipërmarrësit "Albtelecom" sh.a., tek sipërmarrësi "One Telecommunications" sh.a., të rregulluara në aktet përkatëse të nxjerra individualisht nga AKEP, sipas Anekseve që do t'i bashkëngjiten këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1, neni 114 dhe pikës 1, të nenit 115, të Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008, "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, K.Pr.A, dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", duke marrë në konsideratë rëndësinë që paraqet miratimi i këtij vendimi, Këshilli Drejtues i AKEP;

V E N D O S I:

1. Të miratojë transferimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit "Albtelecom" sh.a., tek sipërmarrësi "One Telecommunications" sh.a.
2. Të pajisë me Autorizim Individual sipërmarrësin "One Telecommunications" sh.a., sipas Aneksit 1 bashkëlidhur. Autorizimet Individuale dhënë me këtë vendim hyjnë në fuqi në datën 01.01.2023.

3. Sipërmarrësi “One Telecommunications” sh.a., të vërë në shfrytëzim eficient frekuencat e transferuara, brenda 4 (katër) muajve nga data e hyrjes në fuqi të Autorizimeve Individuale.
4. Të miratojë kalimin e të drejtave të Autorizimeve Individuale, për përdorimin e frekuencave për lidhje fikse radio, nga sipërmarrësi Albtelecom sh.a., tek sipërmarrësi “One Telecommunications” sh.a., sipas Aneksit nr. 2, bashkëlidhur.
5. Të miratojë kalimin e të drejtave të Autorizimeve Individuale, për përdorimin e numeracioneve, nga sipërmarrësi “Albtelecom” sh.a., tek sipërmarrësi “One Telecommunications” sh.a., sipas Aneksit nr. 3, bashkëlidhur.
6. Të miratojë kalimin e detyrimeve të vendosura për FNT (Fuqi të Ndjeshme në Treg), ndaj nga sipërmarrësi Albtelecom sh.a., tek sipërmarrësi “One Telecommunications” sh.a., në përputhje me përcaktimet e Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP, sipas Aneksit 4, bashkëlidhur.
7. Të miratojë kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara sipërmarrësit “Albtelecom” sh.a., tek sipërmarrësi “One Telecommunications” sh.a., nga çdo akt tjetër të AKEP dhe miratimin e zëvendësimit të emrit “Albtelecom” sh.a., me “One Telecommunications” sh.a., në çdo dokument tjetër të miratuar me aktet respektive të AKEP.
8. Në lidhje me kontratën e pajtimit, sipërmarrësi “One Telecommunications” sh.a., duhet të zbatojë përcaktimet e nenit 99, të Ligjit 9918/2008 i ndryshuar, pas përfundimit të bashkimit me sipërmarrësin “Albtelecom” sh.a. Të drejta dhe detyrimet që burojnë nga Kontratat e Pajtimit të lidhura me pajtimtarët e sipërmarrësit Albtelecom sh.a., të mbarten tek sipërmarrësi “One Telecommunications” sh.a.
9. Sipërmarrësi “Albtelecom” sh.a duhet të njoftojë pajtimtarët dhe përdoruesit nëpërmjet mjeteve të qëndrueshme për datën e saktë të kalimit të kontratës së pajtimit tek sipërmarrësi One Telecommunications sh.a.
10. Sipërmarrësi “One Telecommunications” sh.a siguron që bashkimi i shoqërive nuk do të cenojë të drejtat dhe interesat e pajtimtarit në asnjë aspekt, të tilla si standartet e cilësise se shërbimit, mbulimi, kujdesi ndaj klientit, ofrimi i shërbimeve të kontraktuara si dhe atyre të parashikuara në Rregulloren nr.49, datë 11.03.2021 “Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”.
11. Sipërmarrësi “One Telecommunications” sh.a pas përfundimit të bashkimit duhet t’u konfirmojë pajtimtarëve dhe përdoruesve nëpërmjet mjeteve të qëndrueshme për finalizimin e kalimit të kontratës së pajtimit nga Sipërmarrësi Albtelecom sh.a te “One Telecommunications” sh.a.
12. Ky vendim hyn në fuqi në përfundim të procesit të bashkimit me përthithje dhe pas pasqyrimit të ndryshimeve përkatëse të ekstrakteve të shoqërisë Albtelecom sh.a., dhe shoqërisë “One Telecommunications” sh.a., në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

13. Moszbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim për të gjithë sipërmarrësit pjesëmarrës në këtë proces, përbëjnë kundërvajtje administrative do të trajtohen në përputhje me përcaktimet e ligjit 9918/2008, i ndryshuar, dhe kuadrin rregullator në fuqi.

14. Ngarkohen të gjitha strukturat përgjegjëse në AKEP për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim publikohet në faqen e internetit të AKEP, www.akep.al.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Tomi Frashëri	Edlira Dvorani	Ketrin Topçiu	Lorenc Bako	Xhoana Lilaj

ANEKS 1:

Spektri i frekuencave për rrjete celulare, të sipërmarrësit Albtelecom sh.a, të cilat kalojnë tek sipërmarrësi One Telecommunications sh.a.

I. Brezi 900 MHz:

Sipërmarrësi	Brezi i frekuencave Uplink (MHz)	Brezi i frekuencave Downlink (MHz)	Teknologjia	Afati i vlefshmërisë
Albtelecom sh.a / kaluar tek One Telecommunications sh.a	898.4 – 906.2	943.4 -951.2	FDD	01.03.2034

II. Brezi 1800 MHz:

Sipërmarrësi	Brezi i frekuencave Uplink (MHz)	Brezi i frekuencave Downlink (MHz)	Teknologjia	Afati i vlefshmërisë
Albtelecom sh.a / kaluar tek One Telecommunications sh.a	1771.2-1773.0	1866.2-1868.0	FDD	01.03.2034
	1773.2-1784.8	1868.2-1879.8		01.04.2030

III. Brezi 2100 MHz:

Sipërmarrësi	Brezi i frekuencave, Uplink (MHz)	Brezi i frekuencave, Downlink (MHz)	Teknologjia	Afati i vlefshmërisë
Albtelecom sh.a / kaluar tek One Telecommunications sh.a	1950-1965	2140-2155	FDD	30.11.2027
	1910 – 1915		TDD	

ANEKS 2:

Spektri i frekuencave për lidhjet fikse të sipërmarrësit Albtelecom sh.a, të cilat kalojnë tek sipërmarrësi One Telecommunications sh.a:

Nr.	Rreferencat	Drejtimi	Gjerësia e Brezit (MHz)	Brezi (GHz)	Kapaciteti Mbit/s	Distanca Km
1	AKEP-2014-AI-U108-3-45/1	DOBRENJE-TREGTAN	59.30	6.00	1600.00	26.00
2	AKEP-2014-AI-U108-3-48/1	DOBRENJE-TREGTAN	59.30	6.00	1600.00	26.00
3	AKEP-2014-AI-U108-3-49/1	ALB KUKES-TREGTAN	59.30	6.00	1600.00	7.00
4	AKEP-2014-AI-U108-3-50/1	ALB KUKES-TREGTAN	59.30	6.00	1600.00	7.00
5	AKEP-2017-LF-000427	DOBRENJ-ALB BAJRAM CURRI	40.00	11.00	800.00	10.00
6	AKEP-2014-AI-U108-3-53/1	DOBRENJE-MIDE	59.30	6.00	1600.00	26.00
7	AKEP-2014-AI-U108-3-55/1	DOBRENJE-MIDE	59.30	6.00	1600.00	26.00
8	AKEP-2014-AI-U108-3-56/1	ALB PUKE-MIDE	59.30	6.00	1600.00	10.00
9	AKEP-2014-AI-U108-3-58/1	ALB PUKE-MIDE	59.30	6.00	1600.00	10.00
10	AKEP-2021-LF-002177	ALB KRUJE-ALB DTA	29.65	6.00	400.00	20.00
11	AKEP-2021-LF-002176	KODER HIMARE-SHEN VASIL	29.65	6.00	400.00	23.00
12	AKEP-2021-LF-002175	MILE-ALB SARANDE	29.65	6.00	400.00	15.00
13	AKEP-2014-AI-U108-3-84/1	GRAMSH-KANAQ	56.00	13.00	800.00	3.00
14	AKEP-2014-AI-U108-3-85/1	PETRESH-KANAQ	59.30	6.00	800.00	29.00
15	AKEP-2014-AI-U108-3-855/1	ALB CAKRAN-LIKOVUN	28.00	7.00	310.00	10.00
16	AKEP-2014-AI-U108-3-88/1	BUZE MADHE-SELENICE	40.00	11.00	400.00	6.00
17	AKEP-2014-AI-U108-3-89/1	BUZE MADHE-LIKOVUN	40.00	11.00	400.00	12.00
18	AKEP-2014-AI-U108-3-90/1	ZGERBONJ-ALB POLICAN	56.00	13.00	400.00	4.00
19	AKEP-2014-AI-U108-3-91/1	ZGERBONJ-LISI I BECIT	59.30	6.00	800.00	18.00
20	AKEP-2019-LF-001528	CORROVODE-ALB SKRAPAR	40.00	11.00	600.00	1.20
21	AKEP-2020-LF-001645	CORROVODE-THEREPEL	59.30	6.00	800.00	10.00
22	AKEP-2017-LF-000432	ZGERBONJE-THEREPEL	40.00	11.00	800.00	6.00
23	AKEP-2020-LF-001720	LIBOHOVE-KECULLE	59.30	6.00	800.00	12.00
24	AKEP-2013-AI-U108-3-86/1	BUSHAT-BERDICE	14.00	15.00	52.00	6.14
25	AKEP-2013-AI-U108-3-87/1	MOKERR-CERVENAKE	7.00	15.00	16.00	10.05
26	AKEP-2014-AI-U108-3-541/1	Librazhd-Koder Librazhd	27.50	18.00	183.00	4.39
27	AKEP-2014-AI-U108-3-837/1	MEZHGORAN-KURVELESH	14.00	15.00	32.00	21.80
28	AKEP-2013-AI-U108-3-93/1	KRASTE-KLOS	14.00	15.00	16.00	14.40
29	AKEP-2021-LF-002207	MEMALIAJ-GLLAVE	7.00	15.00	40.00	16.50
30	AKEP-2014-AI-U108-3-578/1	KERRABE-PETRESH	40.00	11.00	185.00	12.21
31	AKEP-2014-AI-U108-3-584/1	LISI I TRENIT-HOMESH	40.00	11.00	185.00	15.10
32	AKEP-2021-LF-002167 (AKEP-2020-LF-001839 (AKEP-2013-AI-U108-3-100/1)	MENDRRAKE-SKENDERBEGAS	7.00	15.00	8.00	10.33
33	AKEP-2014-AI-U108-3-582/1	ARAPAJ-KODER DIBER	40.00	11.00	185.00	14.91

34	AKEP-2014-AI-U108-3-535/1	BAJRAM CURRI- ALBTELECOM TROPOJE	28.00	38.00	183.00	1.12
35	AKEP-2014-AI-U108-3-593/1	BARBULLINJE-GRABJAN	30.00	6.00	183.00	18.87
36	AKEP-2013-AI-U108-3-109/1	OSTREN-HOMESH	20.00	6.00	8.00	11.93
37	AKEP-2013-AI-U108-3-112/1	MURSI-MILE	30.00	6.00	155.00	7.91
38	AKEP-2021-LF-002208	BABICE-ZVERNEC	13.75	18.00	40.00	7.83
39	AKEP-2021-LF-001978	Boville-BREGU I LUMIT	28.00	23.00	32.00	2.37
40	AKEP-2013-AI-U108-3-142/1	KANAQ-GJERBES	7.00	7.00	8.00	30.42
41	AKEP-2013-AI-U108-3-138/1	GRABIAN-KRYVIDH	40.00	11.00	150.00	16.65
42	AKEP-2013-AI-U108-3-137/1	RAZEM-BOGE	7.00	15.00	8.00	6.51
43	AKEP-2020-LF-001776	BUSHAT-ASHTÉ	28.00	13.00	183.00	6.65
44	AKEP-2018-LF-001092	HOT I RI- SHTOJI	28.00	15.00	158.00	2.81
45	AKEP-2021-LF-001980	ALBTELECOM FIER- PATOS RERES	14.00	15.00	64.00	10.18
46	AKEP-2021-LF-002209	BERDICE-DRISHT	28.00	11.00	160.00	15.42
47	AKEP-2016-LF-000071	BERDICE-KOLAJ	40.00	11.00	800.00	12.70
48	AKEP-2014-AI-U108-3-47/1	BERDICE-MNELE E MADHE	7.00	15.00	8.00	18.80
49	AKEP-2014-AI-U108-3-576/1	KODER BURREL-KLOS	28.00	13.00	183.00	11.90
50	AKEP-2019-LF-001550	BUSHAT-GJADER	28.00	15.00	88.00	12.08
51	AKEP-2014-AI-U108-3-77/1	BUSHAT-MNELA	7.00	15.00	8.00	19.30
52	AKEP-2021-LF-002193	CANGONJ-ALBTELECOM BILISHT	14.00	13.00	160.00	10.10
53	AKEP-2014-AI-U108-3-151/1	COROVODA-MALINDI	7.00	15.00	8.00	14.40
54	AKEP-2014-AI-U108-3-570/1	DAMES-KODER BALLSH	28.00	13.00	183.00	10.41
55	AKEP-2014-AI-U108-3-552/1	DOBRENJ-RRAGAM	28.00	15.00	183.00	7.00
56	AKEP-2014-AI-U108-3-167/1	GRABIAN-GJUZAJ	14.00	15.00	52.00	16.90
57	AKEP-2021-LF-002028	GRAMSH-ZAVALINA	28.00	15.00	183.00	11.11
58	AKEP-2014-AI-U108-3-575/1	HOMESH-FUSHE BULQIZE	28.00	13.00	183.00	11.20
59	AKEP-2021-LF-002186	KODER BURREL-PERLAT	28.00	11.00	160.00	16.76
60	AKEP-2014-AI-U108-3-609/1	KODER BURREL- TELEKOM BURREL	30.00	6.00	183.00	9.20
61	AKEP-2021-LF-002173	KODER FARKE-BKT HEADQUARTERS	28.00	11.00	180.00	5.30
62	AKEP-2014-AI-U108-3-561/1	KODER FARKE-PETRELE	28.00	15.00	183.00	8.00
63	AKEP-2014-AI-U108-3-590/1	MAJA E KORBIT KORCE- KAMENICE	28.00	7.00	183.00	17.37
64	AKEP-2014-AI-U108-3-206/1	KOTE-VRANISHT	14.00	15.00	32.00	20.00
65	AKEP-2014-AI-U108-3-614/1	ARAPAJ PESHKOPI- ALBTELECOM PESHKOPI	56.00	13.00	422.00	10.60
66	AKEP-2017-LF-000426	KERRABE-GRACEN	28.00	15.00	32.00	8.40
67	AKEP-2019-LF-001544	LIBRAZHD KODER-SHMIL	28.00	15.00	32.00	16.89
68	AKEP-2020-LF-001641	LIGOVUN-SEMAN	40.00	11.00	185.00	13.97
69	AKEP-2014-AI-U108-3-234/1	MENDRRAKA-GRAMSH	7.00	15.00	8.00	10.00
70	AKEP-2021-LF-002195	MIDA-FUSHARREZ	14.00	15.00	160.00	7.90
71	AKEP-2017-LF-000430	MIDE-GJEGJAN	14.00	15.00	16.00	17.20
72	AKEP-2015-AI-U108-3-58/1	PEPELLASH-RADANJ	14.00	15.00	16.00	28.40
73	AKEP-2014-AI-U108-3-595/1	PEPELLASH-VOSKOPOJA	28.00	7.00	183.00	19.33
74	AKEP-2021-LF-002189	PETRESH-ALDEK	14.00	13.00	160.00	11.90

75	AKEP-2017-LF-000428	PLLANA-LURTH	14.00	15.00	32.00	11.20
76	AKEP-2019-LF-001548	PRESPA-LIQENAS	14.00	15.00	32.00	13.34
77	AKEP-2021-LF-002188	QAFE GJASHTA-MUZINA	28.00	11.00	160.00	13.90
78	AKEP-2021-LF-002198	RAZEM-KORES	14.00	15.00	160.00	3.93
79	AKEP-2021-LF-002204	REPS-FAN	14.00	7.00	160.00	23.70
80	AKEP-2021-LF-002203	RREPS-OROSH	28.00	11.00	160.00	12.10
81	AKEP-2014-AI-U108-3-474/1	RREPS-RESHEN	28.00	13.00	155.00	9.80
82	AKEP-2014-AI-U108-3-250/1	SHKEMBI I KAVAJES-MALI I ROBIT	7.00	15.00	16.00	5.20
83	AKEP-2014-AI-U108-3-594/1	ALB BURREL-KRESHTES BULQIZE	28.00	7.00	183.00	19.10
84	AKEP-2020-LF-001761	TEPELENA-KURVELESH	14.00	15.00	44.00	9.80
85	AKEP-2021-LF-002182	TREGTAN-BLERIM	20.00	6.00	160.00	21.10
86	AKEP-2020-LF-001833	TREGTAN-KOLLOVOZ	28.00	15.00	183.00	21.50
87	AKEP-2021-LF-002180	VOSKOPOJA-DARDHE	14.00	7.00	160.00	23.31
88	AKEP-2014-AI-U108-3-601/1	ALB ZVERNEC-HADERAJ	28.00	7.00	183.00	24.48
89	AKEP-2021-LF-002202	ALB ZVERNEC-KARABUN	28.00	11.00	160.00	15.50
90	AKEP-2021-LF-002194	PERLAT-ULZA	14.00	13.00	160.00	10.00
91	AKEP-2014-AI-U108-3-280/1	PERLAT-KURBNESH	7.00	15.00	8.00	11.30
